



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.333, datë 27.10.2023

PËR

**“MIRATIMIN E RELACIONIT MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE
FIGURËS TË KANDIDATES PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E
FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, NË VITIN
AKADEMIK 2022-2023, TË ZONJËS ANISA GIU”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 164 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 32 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Seksionin VI dhe VII të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023, të zonjës Anisa Giu”, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës Anisa Giu, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatës për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Anisa Giu dhe Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 27.10.2023.



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Nurihan Seifi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

Arta Mandro